



## Periodiku AMF

### Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare harton projektligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”

Projektligji vendos parime dhe përcakton veprimtarinë dhe procedurat në lidhje me krijimin, organizimin, administrimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, në mënyrë që tregu i sigurimeve të funksionojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, si dhe për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e konsumatorit të përfshirë në një kontratë sigurimi. Deri më 31 janar 2012, AMF pret mendime nga shoqëritë e sigurimit.

*Vijon në faqen 2*

### Vështrim mbi tregjet

#### Tregu i sigurimeve janar-nëntor 2011

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-nëntor 2011 arritën shifrën 7,688,810 mijë lekë, përkundrajt 7,303,587 mijë lekë të realizuara në periudhën janar-nëntor 2010 ose 5.27% më shumë.

*Vijon në faqen 3*

### Edukimi i konsumatorit

#### Kriza e tanishme financiare dhe mundësia e përhapjes së saj në Evropën Juglindore dhe Evro-Azi: Kush duhet të shqetësohet? Informacion teknik

*(Material i përpunuar, nxjerrë nga faja zyrtare e USAID-it “Partnerët për stabilitet financiar” (PSF) tetor 2011)*

*Vijon nga numri i kaluar.*

(Në numrin e kaluar ju lexuat mbi rolin e sektorit financiar në rritjen ekonomike)

Kushtet e vështira për bankat mbarë evropiane tregojnë se masat e marra për t’iu përgjigjur

tronditjeve të vitit 2008, të cilat mbështeteshin në ndihmën që vinte prej bankave mëmë në Evropën e zhvilluar, nuk mund të përsëritet në vitin 2011-2012.

*Vijon në faqen 5*

### Zhvillime të tjera

#### Takim përmbyllës për vitin 2011 i Kryetares së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni, me shoqëritë e sigurimeve

Rezultat i rëndësishëm i një pune katër vjeçare të stafit të AMF-së është miratimi gjatë vitit 2011 i metodologjisë së re të mbikëqyrjes me fokus riskun në sigurime, si edhe planit strategjik për zbatimin e saj.

*Vijon në faqen 8*

#### Sfida e tanishme është zhvillimi i një tregu rajonal të kapitalit përtej kufijve kombëtarë

Nga Konferenca Ndërkombëtare “Një Pasqyrë e Zhvillimeve të Sektorit Financiar Jo-bankar”

Synimi i zhvillimit të kësaj konference ishte prezantimi i politikave të reja në sektorin financiar jo-bankar, nxitja e diskutimeve për situatën e tregut rajonal dhe zhvillimin e saj të ardhshëm.

*Vijon në faqen 9*

#### Bashkëpunim rajonal për vendosjen e standardeve ndërkombëtare në tregun e letrave me vlerë

Nga mbledhja e Komitetit Evropian të IOSCO-s

Pjesëmarrja e AMF-së në këtë takim i shërbeu zhvillimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe pikëpamjeve për zhvillimet e reja të tregut financiar jo-bankar rajonal dhe forcimit të bashkëpunimit midis autoriteteve mbikëqyrëse në këtë sektor të rëndësishëm financiar.

*Vijon në faqen 11*

Në këtë numër:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare harton projektligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” 2

Vështrim mbi tregjet 3

Edukimi i konsumatorit 5

Zhvillime të tjera 8

## Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare harton projektligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”

<http://amf.gov.al/pdf/fokus/Projektligji%20Per%20veprimtarine%20e%20sigurimit%20dhe%20risigurimit.pdf>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dorëzoi në dhjetor 2011 projektligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” me qëllim, forcimin dhe zhvillimin e sektorit të sigurimeve në vend, duke vënë theksin në garantimin e një mbrojtje efektive të interesave të konsumatorëve.

Ky projektligj është rezultat i punës 2 vjeçare të AMF-së, me synim plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e sigurimeve dhe përmbushjen e angazhimeve për përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian. Vlen të përmendet, se ky projektligj është produkt i bashkëpunimit me Bankën Botërore dhe ekspertë të huaj të fushës së sigurimeve, të cilët sollën përvojën e tyre në hartimin e ligjit, duke u nisur edhe nga përvoja dhe tregjet e sigurimit të ngjashme me ato të vendit tonë dhe në përafrimin e legjislacionin vendas me atë evropian.

Projektligji i ri është vazhdimësi e ligjit ekzistues dhe është hartuar duke marrë parasysh kërkesën në rritje të tregut të sigurimeve, zhvillimet më të fundit të këtij tregu dhe formën e re të mbikëqyrjes.

Projektligji vendos parime dhe përcakton veprimtarinë dhe procedurat në lidhje me krijimin, organizimin, administrimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, në mënyrë që tregu i sigurimeve të funksionojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, si dhe për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e konsumatorit të përfshirë në një kontratë siguri.

Risitë e sjella nga ky projektligj janë:

- klasifikimi i rreziqeve të mëdha dhe riformulimi i klasave të jetës, të cilat janë përputhur me direktivat evropiane në fushën e sigurimeve;

- drejtimi i shoqërisë së sigurimit me një nivel, si dhe kërkesat për qeverisje sa më të mirë të shoqërisë;
- kërkesat që duhet të plotësojnë personat kyç në vendimmarrjen dhe drejtimin e shoqërisë, duke parashikuar se ata duhet të jenë të aftë dhe të përshtatshëm për të marrë përsipër këto role;
- informimi i të siguruarit nga shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit, përpara nënshkrimit të kontratës, në lidhje me subjektin e sigurimit, mbulimin dhe çështje të tjera. Detyrimi për informim fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë të kontratës;
- mbikëqyrja e re me fokus rrisht. Këto dispozita përfshihen në projektligj edhe në kuadër të hartimit dhe miratimit nga ana e Autoritetit të Manualit të Mbikëqyrjes me Fokus Rrisht. Koncepti bazë i metodologjisë së re të mbikëqyrjes është të identifikojë zonat me rrisht më të lartë në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit dhe kur është e nevojshme, të punojë me menaxhimin e shoqërisë, në mënyrë që të ulë rrishtin në nivele të pranueshme;
- përfshirja e dispozitave për ushtrimin e veprimtarisë në territorin e Republikës së Shqipërisë nga shoqëritë e vendeve anëtare, nëpërmjet themelimit të degës apo ofrimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve. Të gjitha dispozitat e këtij projektligji, të cilat japin përcaktime për shoqëritë e vendeve anëtarë, do të hyjnë në fuqi pas anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Gjatë hartimit të projektligjit janë marrë parasysh gjithashtu aktet ligjore në fushën e sigurimeve të disa vendeve si: Kroaci, Austri, Itali, Bullgari, Hungari, Maqedoni, etj. Mbështetja në kuadrin ligjor të vendeve të rajonit ka pasur si qëllim edhe standardizimin e legjislacionit vendas me atë të vendeve fqinje me problematika të ngjashme të tregjeve financiare.

Vënia në zbatim e këtij projektligji do të krijojë pikërisht hapësirën e duhur për zhvillimin dhe rritjen e tregut të sigurimeve dhe nuk do të ketë


efekte negative në treg. Krahas të tjerave do të hartohen dispozita tranzitore për shoqëritë e sigurimeve dhe ndërmjetësit në sigurime, deri sa ato të përshtaten me kërkesat e reja ligjore.

Ligji është vendosur në faqen zyrtare të AMF-së për të marrë mendime nga shoqëritë e sigurimit deri më datën 31 janar 2012. Ndërkohë projektligji i është dërguar Ministrisë së Financave për ndjekjen e procedurave të miratimit.

## Vështrim mbi tregjet


### Tregu i sigurimeve janar - nëntor 2011

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-nëntor 2011 arritën shifrën 7,688,810 mijë lekë, përkundrajt 7,303,587 mijë lekë të realizuara në periudhën janar-nëntor 2010 ose 5.27% më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 54.98% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 45.02% të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 30.37% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje 2.96% të sigurimeve të Jo-Jetës. 87.56% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 12.22% nga veprimtaria e Jetës dhe 0.22% u gjenerua nga veprimtaria e risigurimit. Në janar-nëntor 2011 u nënshkruan rreth 1,187,467 kontrata sigurimi, ose rreth 94.87% më shumë se në janar-nëntor 2010.



### Volumi i primit të shkruar bruto, janar-nëntor (2010-2011)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2010	2011
<b>Janar-Nëntor</b>		
A) Sigurim i Jetës	720,796	939,710
B) Sigurim i Jo-Jetës	6,538,698	6,731,983
a) Sigurimi i Detyrueshëm	3,869,195	3,461,150
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	2,669,503	3,270,833
C) Risigurimi	44,093	17,117
<b>TOTAL</b>	<b>7,303,587</b>	<b>7,688,810</b>



### Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar-nëntor 2011, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 3,461,150% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-nëntor 2011, arritën 2,036,552 mijë lekë, ose 24.48% më pak se në janar-nëntor 2010.

Në janar-nëntor 2011, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 1,047,961 mijë lekë, ose rreth 30.54% më shumë se në janar-nëntor 2010.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-nëntor 2011 arritën në 376,637 mijë lekë, apo 1.88% më shumë se në janar-nëntor të 2010.

### Sigurimet vullnetare

Në janar-nëntor 2011, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 4,227,661 mijë lekë, ose 23.10% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 3,270,833 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet

nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 34.60%, të pasuara nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit me 24.85% dhe nga sigurimi kasko me 17.52%, peshë më të ulët patën sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile, sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-nëntor 2011, arritën në 812,936 mijë lekë, 140.85% më shumë se në janar-nëntor 2010. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 88.65% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e Jetës në janar-nëntor 2011 arritën në 939,710 mijë lekë, ose rreth 30.37% më shumë se në janar-nëntor 2010. Rritja në sigurimet e jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies.

### Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal Uniqa Group Austria, Sigma Vienna Insurance Group, Insig, Atlantik, Interbalkan, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 32.91% të primeve.

Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life Uniqa Group Austria, Insig dhe Sicred. Sigal-Life Uniqa Group Austria udhëhoqi tregun me 49.07% të primeve.





## Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-nëntor 2011 kapi vlerën 1,923,886 mijë lekë, ose 0.95% më pak se në janar-nëntor 2010. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,536,748 lekë, apo 79.88% të totalit.

## Edukimi i konsumatorit

### **Kriza e tanishme financiare dhe mundësia e përhapjes së saj në Evropën Juglindore dhe Evro-Azi: Kush duhet të shqetësohet? Informacion teknik**

[www.pfsprogram.org/pfs-technical-brief-4-financial-crisis-and-contagion-who-should-worry](http://www.pfsprogram.org/pfs-technical-brief-4-financial-crisis-and-contagion-who-should-worry)

(Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e USAID-it "Partnerët për stabilitet financiar" (PSF) tetor 2011)

Vijon nga numri i kaluar

(Në numrin e kaluar ju lexuat: 1. përmbledhjen e materialit, si dhe 2. rolin e sektorit financiar në rritjen ekonomike)

### **3. Kriza e borxhit shtetëror në Evropë dhe ekonomitë e Evropës Juglindore dhe Evro-Azisë**

#### **Si mundet një vend i vogël të nxjerrë nga shinat rimëkëmbjen ekonomike të mbarë botës?**

Politikëbërësit dhe rregullatorët në ekonomitë e zhvilluara dhe në ato në zhvillim po bëjnë shumë përpjekje për të hartuar dhe zbatuar politika për arritjen e stabilitetit makroekonomik dhe financiar në një mjedis gjithnjë e më të vështirë. Pasi PFS nxori materialin e parë teknik në janar 2011, në të cilin shiheshin risqet e përhapjes në sektorët financiarë të Evropës Juglindore dhe Evro-Azisë<sup>1</sup>, janë rritur shqetësimet në lidhje me krizën e borxhit shtetëror të Eurozonës. Edhe pse Greqia shpesh konsiderohet si fytyra përfaqësuese e

<sup>1</sup> Shih informacionin teknik 1 "Kriza financiare globale dhe ndikimi në sektorët financiarë në Evropën Juglindore dhe Evro-Azi: stabiliteti financiar, prekshmëria dhe mësimet e nxjerra", janar 2011, <http://pfsprogram.org/node/4398>.

krizës, shqetësimet kanë përfshirë ekonomi më të mëdha, duke trazuar kështu tregjet, duke i vendosur në pozita të vështira politikëbërësit dhe duke e ridrejtuar vëmendjen në shëndetin e sistemit bankar botëror.

Prej thujse dy vjetësh, Evropa po punon për të identifikuar dhe zbatuar masat që do t'i stabilizojnë tregjet në vështirësi. Fatkeqësisht, këto përpjekje kanë mbetur mbrapa në krahasim me zhvillimet e tregjeve dhe nuk u kanë dalë problemeve përpara. Edhe shtypi dhe publiku i gjerë e kanë të vështirë të kuptojnë se si ekonomia e Greqisë, një ekonomi aq e vogël, është duke shkaktuar probleme në nivel botëror. E thënë shkurt, *Greqia ishte një paralajmërim për problemet e mëdha që dukeshin në horizont dhe i detyroi të gjithë të kuptonin se disa vende të Eurozonës mund të mos ishin në gjendje t'i shlyenin borxhet*. Problemi nuk është se ekonomia e Greqisë është shumë e madhe, e për këtë nuk duhet lënë në baltë, por se kjo ekonomi është shumë e lidhur, duke qenë anëtare e bashkimit monetar evropian dhe e një sistemi financiar mbarëevropian, i cili ka lindur me futjen në qarkullim të euros në vitin 1999.

*Edhe pse nuk ndodhemi në prag të një krize të re financiare botërore, janë rritur mundësitë e tronditjes së tregjeve financiare dhe ekonomive për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve nga një vend anëtar i eurozonës. Një mosshlyerje e detyrimeve nga ana e një shteti ose nga ana e një firme financiare të rëndësishme për sistemin mund të përhapte dallgë tronditëse në të gjitha tregjet financiare dhe ky rrezik i ka detyruar udhëheqësit në Evropë dhe në mbarë botën të kërkojnë pasjen e një plani të bashkërenduar veprimi. Megjithatë, për Evropën, një pengesë e rëndësishme për gjetjen e një zgjidhjeje vendimtare ndaj problemit i ka rrënjët në strukturën e copëzuar vendimmarrëse të vendeve të eurozonës, e cila e ka penguar vullnetin politik gjatë dy vjetëve të fundit për të reaguar në mënyrë më të vendosur ndaj krizës. Për shembull, kohët e fundit kemi parë se si Sllovakia e vogël i vonoi gjërat dhe thujse e nxori nga shinat planin e Evropës për Kreditë Evropiane për Stabilitet Financiar, synimi i*

së cilës ishte qetësimi i tregjeve globale dhe i publikut në lidhje me vullnetin dhe mjetet e Evropës për t'i bërë ballë krizës.

### **Cila do të jetë rruga që do të ndjekë kriza?**

Ndërsa kriza evropiane e borxhit arrin kulmin dhe udhëheqësit botërorë zbatojnë zgjidhje, duket qartë se do të ketë zhvillime të padëshirueshme. Megjithatë, nuk është e qartë sa të rënda do të jenë pasojat dhe nëse këto pasoja do të jenë të befta apo të zgjata për veprimtaritë ekonomike. Përgjigjet për pyetjet e ngutshme do të përcaktojnë shkallën e pasojave dhe kanalet e transmetimit do të përcaktohen nga mënyra se si investitorët dhe tregjet u përgjigjen zgjidhjeve të zbatuara nga udhëheqësit.

Nëse pasojat vijnë në formën e një tronditjeje, kanali më i mundshëm i transmetimit do të jetë sektori financiar. Ndërsa sektori financiar po lufton me stresin mbi likuiditetin dhe zhvlerësimet e mundshme të aktiveve në formën e obligacioneve shtetërore, rënia e veprimtarisë huadhënëse dhe mungesa e likuiditetit në treg do të ndjehet edhe në ekonominë reale. Vendet me sektorë financiarë më të qëndrueshëm, sidomos me banka me nivele më të forta kapitali dhe me nivele më të ulëta kredish të këqija, do të kenë më shumë kohë për të reaguar dhe për t'u përshtatur. Mirëpo, nëse ngrin huadhënia ndërbankare, sikurse ndodhi në vjeshtën e vitit 2008, tregjeve globale nuk do t'u hyjë shumë në punë niveli i kapitalit apo aktivet e kredive të këqija të bankave. Fondet do të pakësohen për të gjitha bankat dhe palët në sektorët financiarë dhe ata realë do të bëjnë çdo përpjekje për të ruajtur para dhe për të shkuar në vende më të sigurta.

### **Përse përbën shqetësim kriza e borxhit shtetëror e eurozonës për Evropën Juglindore dhe Evropën Azinë?**

Vendet më të prekshme nga epidemia e krizës së eurozonës janë ato me ekonomi të paqëndrueshme dhe/ose sektorë ekonomikë të paqëndrueshëm,

gërshetuar kjo me lidhje të forta me bankat mbarë evropiane dhe marrëdhënie të forta tregtare dypalëshe me ekonomi të dobësuar si ato të Greqisë, Italisë dhe Spanjës. Në përgjithësi, ekonomitë e Evropës Juglindore janë më të ekspozuara ndaj epidemisë së eurozonës, në krahasim me Evropën Azinë, për shkak të lidhjeve tregtare dhe rolit dominues që luajnë bankat mbarë evropiane në këtë rajon.

Edhe me një zgjidhje të rregullt të krizës së borxhit të eurozonës, do të ketë humbje sa i takon stabilitetin makroekonomik, stabilitetin të sektorit financiar, tregtisë dhe eksportit, investimeve të huaja, mundësisë për të marrë kredi dhe prosperitetit në përgjithësi. Humbësit më të mëdhenj do të jenë ato vende ekonomitë dhe sektorët financiarë të cilave janë të lidhura më ngushtë me ekonomitë e prekura nga problemet fiskale apo me firma që nuk kanë më likuiditet ose u ka rënë vlera për shkak të humbjeve (për shembull, zhvlerësim i instrumenteve të borxhit shtetëror dhe humbje nga huadhënia në sektorin privat).

Në shumë prej vendeve të Evropës Juglindore dhe Evropës Azisë sot, stabiliteti makroekonomik dhe i sektorit financiar është dobësuar nga kriza e fundit financiare. Vendet që mbulon programi PFS me sektorët financiarë<sup>2</sup> më pak të qëndrueshëm janë Azerbajxhani, Mali i Zi, Gjeorgjia, Serbia, Bosnje-Hercegovina dhe Ukraina. Sektorët bankarë në këto vende kanë qenë qysh më parë të ngarkuar me nivele të larta të kredive problematike, fitime të ulëta, zbulim të lartë ndaj risqeve që sjell huadhënia në monedhë të huaj dhe nga vështirësi të tjera.

Duke qenë se shumë prej bankave filiale në Evropën Juglindore dhe Evropën Azinë të grupeve bankare mbarë evropiane mbështeten në fondet që marrin nga shoqëritë mëmë, në kushtet ku e kanë rritur huadhënien në tregjet e tyre lokale, stresi mbi shoqëritë mëmë ka të ngjarë të ketë ndikim negativ në rritjen ekonomike dhe huadhënien në Evropën

<sup>2</sup> Sipas matjeve të PFS-së. Shih: Raportin krahasues rajonal të PFS-së, tetor 2011.

Juglindore dhe Evro-Azi. Një shembull i mirë është përvoja e Malit të Zi, gjatë viteve 2008-2009. Vlen të thuhet gjithashtu se strukturat e pronësisë të bankave me kontroll të huaj që ushtrojnë aktivitet në Evropën Juglindore dhe Evro-Azi janë ndonjëherë të ndërlikuara dhe krijojnë probleme komplekse, duke përfshirë edhe problemet e shlyerjes së pasiveve në rast falimentimi.

Duke pasur parasysh mjedisin e brishtë, firmat e sektorit privat, firmat financiare, sidomos bankat dhe autoritetet qendrore (për shembull, bankat qendrore, entet rregullatore, autoritetet e sigurimit të depozitave, etj.) duhet të përgatiten për një përhapje të mundshme të krizës së borxhit shtetëror të Evropës. Autoritetet e sektorit publik dhe privat duhet të kenë plane të hollësishme krize për të dyja rastet (recesion i zgjatur ose tronditje financiare). Tronditjet financiare lëvizin me shpejtësi dhe kërkojnë veprim vendimtar dhe komunikim të efektshëm për të parandaluar përhapjen e tronditjes nga komprometimi i stabilitetit financiar dhe nga rënia e besimit. Nëse tronditjet nuk trajtohen në mënyrë të efektshme, mund të ketë një përhapje të shpejtë të krizës, e cila e ul besimin dhe i shpejton efektet e tjera negative për ekonominë dhe familjet që mund të sjellë riorganizim madhor, një krizë krediti dhe panik në një situatë të skajshme.

#### **Sektori financiar i Malit të Zi ishte ai që u godit më shumë nga kriza e vitit 2008, në Evropën Juglindore**

*Forcat shtytëse fillestare qenë tërheqjet në masë të depozitave, të cilat shtruan likuiditetin dhe e vunë në sprovë qëndrueshmërinë e sistemit bankar. Në fazat e para, bankat më të huaja (të cilat kanë në pronësi pjesën më të madhe të sistemit bankar) dhanë mbështetje të konsiderueshme me likuiditet për shoqëritë e kontrolluara të tyre, duke e zbutur tkurrjen e kreditimit. Por pas rimëkëmbjes së depozitave në muajin prill 2009, ato e tërhoqën të gjithë mbështetjen që kishin dhënë më parë, duke e lënë në rënie kreditimin bankar.*

Burimi: Raporti përvendin, FMN, maj 2010

#### **A janë të përgatitura autoritetet e sektorit financiar për t'iu përgjigjur me efektivitet një tronditjeje të mundshme financiare?**

Disa tregues dëshmojnë se sektorët bankarë në Evropën Juglindore dhe Evro-Azi duken të shëndetshëm. Edhe pse bankat në shumicën e vendeve kanë nivele relativisht solide kapitali dhe fitimprurjeje, bankat në rajon i kanë pllakosur problemet që lindin nga kreditë problematike të cilat janë nënprodukte të pasojave që ka sektori real nga kriza e mëparshme.<sup>3</sup>

Në Evropën Juglindore dhe në disa vende të Evro-Azisë ku ka lidhje të konsiderueshme me bankat mbarëevropiane, autoritetet i njohin këto risqe dhe janë më të përgatitura për kapërcimin se një tronditjeje financiare, në krahasim me krizën e vitit 2008-2009. Institucionet financiare ndërkombëtare (FMN-ja dhe, më pak, BERZH-i e Banka Botërore) i kanë këshilluar rregullatorët dhe bankat qendrore në këto vende të zhvillojnë kapacitetet për menaxhimin e krizave.

#### **4. Perspektiva**

*Edhe pse kriza nuk ndodhet në prag, kushtet janë bërë gjithnjë e më të brishta. Pavarësisht masave që kanë marrë udhëheqësit botërorë dhe evropianë, do të ketë pasoja me ndikim në ekonominë dhe sektorët financiarë në të gjithë Evropën Juglindore dhe në pjesë të Evro-Azisë. Do të ketë pasoja për perspektivën e rritjes ekonomike dhe edhe pse ka shumë pyetje të mbetura pa përgjigje, duhet që autoritetet e vendeve të Evropës Juglindore dhe Evro-Azisë të jenë të përgatitura për një transmetim të mundshëm të krizës së Evropës në ekonominë a sektorët financiarë lokalë të tyre.*

<sup>3</sup> Shih materialin teknik 3 të PFS-së, "Nivelet e larta të kredive problematike në Evropën Juglindore dhe Evro-Azi: vrasësi i pazhurmshëm i rritjes ekonomike", gusht 2011, <http://www.pfsprogram.org/high-levels-problem-loans-southeast->

## Zhvillime të tjera

**Takim përmbyllës për vitin 2011 i Kryetares së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni me median dhe përfaqësuesit e tregjeve të mbikëqyruara**



Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF-së, dhjetor 2011

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Elisabeta Gjoni, zhvilloi më datë 29 dhjetor 2011, takimin me median dhe shoqëritë e sigurimeve, në përmbyllje të vitit 2011.

Në fjalën përshëndetëse, Zj. Gjoni vuri në dukje arritjet e institucionit gjatë 2011 në drejtim të kuadrit rregullues dhe legjislativ për mbikëqyrjen financiare, duke vënë theksin tek **Metodologjia e Mbikëqyrjes me Fokus Riskun**, si dhe hartimi i projektligjit “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Gjatë vitit 2011, AMF ka vazhduar me hartimin e akteve nënligjore në fushën e titujve, në fushën e pensioneve vullnetare, në zbatim të ligjeve të reja të hartuara dhe miratuara gjatë vitit 2010, si dhe në fushën e sigurimit të detyrueshëm si pasojë e amendimit të ligjit të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, ku shoqëritë e sigurimit I përcaktojnë vetë tarifat e primit të sigurimit sipas kushteve të tregut.

Rezultat i rëndësishëm i një pune katër vjeçare të stafit të AMF-së është miratimi gjatë vitit 2011 i metodologjisë së re të mbikëqyrjes me fokus riskun në sigurime, si edhe planit strategjik për zbatimin e saj.

Kuadri i ri dhe i plotë rregullator në fushën e shërbimeve financiare jo-bankare ka çuar në shtimin e subjekteve që veprojnë në treg.



Përfaqësues të shoqërive në takimin e fundvitit në AMF

**Tregu i pensioneve vullnetare private** njohu zhvillime pozitive në drejtim të licencimit.

Autoriteti ka licencuar **shoqëri administruese të fondeve të pensionit vullnetar, si dhe një sërë bankash si ofruese të shërbimeve (depozitar / kujdestar)**. Sot në treg operojnë tri shoqëri administruese të fondeve të pensioneve vullnetare dhe 14 ofrues të shërbimeve në fushën e pensioneve dhe letrave me vlerë. Edhe **tregu i letrave me vlerë** gjatë vitit 2011 njohu zhvillime pozitive në drejtim të licencimit. Autoriteti licencoi shoqërinë e parë administruese të fondeve të investimeve, si dhe miratoi emetimin e parë të



obligacionit me ofertë private.

Në tregun e sigurimeve është zgjeruar numri i operatorëve dhe është rritur pjesëmarrja e kapitalit të huaj në vend. Gjithashtu shoqëri shqiptare të sigurimeve kanë shtrirë veprimtarinë e tyre jashtë territorit të Shqipërisë, në Kosovë dhe Maqedoni.

Drejtim tjetër i punës së AMF-së ka qenë licencimi apo autorizimi i profesionistëve të fushës. Kështu këtë vit AMF ka autorizuar 13 aktuarë profesionistë të tregut të sigurimeve. Viti 2011, shënoi dhe vitin e parë të ushtrimit të këtij profesioni sipas licencave të dhëna nga Autoriteti. Është shtuar numri i vlerësuesve të rinj të dëmeve të licencuar duke arritur në 54 individë. Po kështu edhe numri i ndërmjetësve në sigurime (brokera/agjentë) ka ardhur në rritje.

Në tregun e sigurimeve **liberalizimi i tregut të MTPL-së** gjatë 2011 solli rritjen e konkurrencës në tregun e sigurimeve dhe nxitjen e vëmendjes së AMF-së për rregullimin dhe mbikëqyrjen e procesit të liberalizimit.

AMF ka forcuar bashkëpunimin me institucionet homologe në rajon dhe institucionet brenda vendit. Këtë vit takimi i dytë rajonal i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore u organizua nga AMF në Tiranë.

AMF në vitin 2011 ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Shkëmbimi të Informacionit me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, për të mundësuar kontrollin e zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve motorike që lëvizin në vend me kontrata sigurimi të vlefshme dhe zvogëlimin e numrit të mjeteve të transportit të pasiguruara.

Zhvillimi i teknologjisë dhe i programimeve informatike në AMF kanë mbështetur zhvillimet e tregjeve që AMF mbikëqyr. Në këtë aspekt është investuar në ndërtimin e sistemit të shkëmbimit të

të dhënave në mënyrë automatike me Ministrinë e Brendshme, si edhe me Ministrinë e Transportit, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka një plan afatmesëm me objektiva të përcaktuara qartë në çdo fushë të tregut financiar jo-bankar për zhvillimin e arritjen e mëtejshme të standardeve ndërkombëtare.

### **Sfida e tanishme është zhvillimi i një tregu rajonal të kapitalit përtej kufijve kombëtarë**

Nga Konferenca Ndërkombëtare "Një Pasqyrë e Zhvillimeve të Sektorit Financiar Jo-bankar"

<http://www.fsc.bg/>

Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë, (BFSC) zhvilloi në datën 14 dhjetor në Sofje, Bullgari, Konferencën Ndërkombëtare me temë "**Një Pasqyrë e Zhvillimeve të Sektorit Financiar Jo-bankar**".

Synimi i zhvillimit të kësaj konference ishte prezantimi i politikave të reja në sektorin financiar jo-bankar, nxitja e diskutimeve për situatën e tregut rajonal dhe zhvillimin e saj të ardhshëm.

Në kontekstin e sfidave aktuale financiare me të cilat Evropa përballet, çështja kryesore për situatën e tregut evropian të letrave me vlerë bëhet vendimtare dhe nevoja për të siguruar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e sektorit financiar sot është e padiskutueshme. Nga ana tjetër tregjet e kapitalit të Evropës Qendrore, Lindore dhe rajonit të Ballkanit mbeten relativisht të vogla dhe të kufizuara brenda kufijve kombëtarë dhe në të njëjtën kohë në presion nga faktorë të jashtëm. Në këtë kontekst, BFSC inicioi dialogun me partnerët rajonalë dhe BE-në, si dhe me aktorët lokalë në mënyrë që të prezantojë një strategji të re për zhvillimin e sektorit të letrave me vlerë dhe forcimin e aftësisë konkurruese të kompanive.

Në Konferencë morën pjesë zyrtarë të lartë nga



Gjatë zhvillimit të Konferencës Ndërkombëtare me temë “Një Pasqyrë e Zhvillimeve të Sektorit Financiar Jo-bankar” Sofie, Bullgari



Qeveria e Bullgarisë, Komisioni Evropian, Banka Botërore dhe Autoriteti Evropian i Tregut të Letrave me Vlerë (ESMA), që mbikëqyr dhe ruan stabilitetin financiar të BE-së, përfaqësues nga rregullatorë dhe mbikëqyrës të Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe pjesëmarrës të tregut financiar jo-bankar nga rajoni.

Aktiviteti u hap nga Z. Bojko Borisov, kryeministër i Bullgarisë. Kjo i dha një sinjal të qartë dhe të fortë të biznesit për përpjekjet që po bëhen dhe mbështetjen nga ana e qeverive ndaj tyre për të kapërcyer pasojat e krizës globale në sektorin financiar jobankar. Në fjalën e tij Kryeministri theksoi se Bashkimi Evropian është në prag të marrjes së vendimeve shumë të rëndësishme për zhvillimin e tij të ardhshëm, shumë prej të cilëve janë të lidhur me sigurinë dhe stabilitetin financiar të tregjeve financiare. Në këtë situatë, roli i autoriteteve që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e sektorit financiar është vendimtar. Në kohën e krizës financiare nga institucionet shtetërore kërkohet të luftojnë për të përforcuar besimin e njerëzve në stabilitetin e tregjeve për të siguruar funksionimin e mirë të tyre dhe integritetin e duhur.

Kryetari i BFSC-së theksoi se kriza financiare ka ndikuar shumë në tregjet globale financiare. Kjo kërkon veprim të menjëhershëm për të kapërcyer pasojat dhe për të stabilizuar tregjet financiare në mbarë vendin. Rregullatorët financiarë të rajonit duhet të mbështesin veprimet e Komisionit

Evropian dhe së bashku me autoritetet rregullatore të shteteve anëtare të tjera të interesohen në kërkimin e zgjidhjeve dhe krijimin e politikave për mbikëqyrje efektive të sistemit financiar, në mënyrë që të promovojnë hapa më të qëndrueshëm, transparentë, të parashikueshme dhe të përgjegjshme ndaj publikut, investitorëve dhe konsumatorëve.

Një i ftuar i veçantë në këtë konferencë ishte z. Steven Maijoor – Presidenti i Autoritetit Evropian të Tregut të Letrave me Vlerë. Ai i dha mbështetje të fortë konferencës në qëllimin e saj dhe prezantoi detyrat dhe prioritetet e ESMA-s. Me rëndësi ishte prezantimi mbi Mifid (Market in Financial Instruments Directive), Tregu në kuadrin e Direktivës mbi Instrumentet Financiare dhe zbatimi i tyre si një standard global në vendet në zhvillim, eksperiencat rajonale, si dhe propozimet legjislative.

Në vazhdim konferenca u nda në dy panele diskutimi: sesioni mbi fondet e pensioneve në kushtet e krizës financiare dhe perspektivat për futjen e multifunds dhe sesioni mbi mbrojtjen konsumatore dhe moduli i edukimit financiar.

Marcus Repnik, përfaqësues i përhershëm i BB-së, për Bullgarinë, Çekinë dhe Sllovakinë theksoi, që rregullatorët duhet të luajnë një rol kyç në forcimin e tregjeve të kapitalit. “Sfida tani është që të zhvillojmë një treg rajonal të kapitalit i cili kalon kufijtë kombëtarë”- tha ai. Kjo do të lejojë mundësi

më të mira për investime në kushtet kur shërbimet financiare dhe produktet janë duke u bërë më të sofistikuar dhe komplekse dhe konsumatorët duan rregulla më të qarta dhe një mbikëqyrje më efektive dhe të përgjegjshme.

Pjesëmarrja e Znj. Enkeleda Shehi, Nënkryetare e AMF-së në këtë takim i shërbeu zhvillimit, shkëmbimit të informacionit dhe pikëpamjeve për zhvillimet e reja të tregut financiar jo-bankar dhe forcimit të bashkëpunimit midis autoriteteve mbikëqyrëse në këtë sektor të rëndësishëm financiar.

### **Bashkëpunim rajonal për vendosjen e standardeve ndërkombëtare në tregun e letrave me vlerë**

Mbledhja e Komitetit Evropian të IOSCO-s

<http://www.iosco.org/>  
<http://www.fsma.be/>  
[http://www.fsma.be/en/News/Article/press/div/2011-12-15\\_iosco.aspx](http://www.fsma.be/en/News/Article/press/div/2011-12-15_iosco.aspx)

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Letrave me Vlerë, në bashkëpunim me Autoritetin e Tregjeve dhe Shërbimeve Financiare të Belgjikës zhvilluan në datat 14-15 dhjetor në Bruksel, Belgjikë, mbledhjen e radhës të Komitetit Evropian të IOSCO-s (ERC Meeting).

Në strukturën e IOSCO-s ndër të tjera funksionojnë edhe katër komitete të specializuara rajonale me anëtarë sipas rajoneve. Ato mblidhen rregullisht për të diskutuar problemet rajonale. Këto komitete janë: Komiteti Evropian ku AMF është anëtare; Komiteti i Afrikës dhe Lindjes së Mesme; Komiteti Aziatik dhe Pacifik dhe Komiteti Inter Amerikan.

Mbledhja e Komitetit Evropian është një moment kyç për anëtarët e IOSCO-s të rajonit të Evropës ku ata marrin informacione dhe shkëmbejnë eksperiencën e pikëpamjeve mbi aktivitetin e Komitetit, çështjet e mbikëqyrjes rajonale e më gjerë të tregut të letrave me vlerë, diskutime në

lidhje me draft dokumentet e hartuara nga komiteti për periudhën deri në mbledhjen vjetore me synim forcimin e standardeve ndërkombëtare në këtë treg. Në mbledhjen e radhës të Komitetit Rajonal Evropian mori pjesë Znj. E. Gjoni, Kryetare e AMF-së. Ndër problemet që u trajtuan në këtë mbledhje përmendim:

- Një përmbledhje e zhvillimeve të mbledhjes së kaluar të ERC-së dhe vendimet e marra; vendimet kryesore të ndërmarra në mbledhjen e fundit të përbashkët të Komitetit Ekzekutiv dhe Teknik të IOSCO-s të zhvilluar në 30 shtator; vendimet e mbledhjes së fundit të G20-ës që lidhen me zhvillimet e fundit financiare; diskutime mbi situatën aktuale që po kalojnë tregjet e letrave me vlerë në rajonin e Evropës; nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Gjermanisë u paraqit një prezantim mbi zhvillimet e fundit rregullatore në këtë institucion dhe u dhanë eksperiencat më të mira, si dhe u diskutua studimi “Perspektivat e sektorit financiar në vendet evropiane dhe zhvillimet rregullatore të lidhura me to”.
- Një prezantim nga IOSCO mbi statusin aktual të nënshkruesve të MMoU-së ku u paraqit progresi i aplikimeve dhe përpjekjet për kapjen e afatit të fundit që është viti 2013 në përputhje me Drejtimin Strategjik të IOSCO-s. Në korrik të vitit 2011 nga IOSCO u propozuan hapat që duhet të ndërmarrin komitetet rajonale për të promovuar progresin e aplikantëve dhe nxitur aplikimin e vendeve jo-anëtare.
- Prezantimin e komitetit mbi Drejtimin Strategjik të IOSCO-s. Drejtimi strategjik ka shërbyer në fushën e ruajtjes dhe përmirësimit të kuadrit rregullator por ai ka nevojë për përmirësime në kushtet e krizës globale financiare, ndryshimet në arkitekturën globale financiare dhe progresin e bërë në përputhje me drejtimin aktual strategjik. Në këto kushte u dhanë udhëzime për procesin e unifikimit të politikave dhe të punës për vendosjen e standardeve në komisionet e

përhershme dhe grupet e punës së IOSCO-s, si dhe u ftuan anëtarët për të aplikuar për pjesëmarrje në këto grupe pune.

- Shkëmbimin e mendimeve e pikëpamjeve për çështje të interesit të anëtarëve të komitetit si për rezultatet e raportit të konsultimeve në komentet e anëtarëve, për hapat e ardhshëm që do të ndërmerren, si dhe kërkesa për udhëzime shtesë në çështjet e anëtarësimit.
- Prezantimin nga European Securities Market Authority, ESMA (Autoriteti Evropian i Tregut të Letrave me Vlerë) mbi MiFID (Market in Financial Instruments Directive), tregun në kuadrin e Direktivës, zbatimi i tyre si një standard global në vendet në zhvillim dhe abuzimet në treg, si dhe një udhëzues mbi sistemet dhe kontrollet në një mjedis tregtar shumë të automatizuar për platforma tregtare, firmat investuese dhe autoritetet kompetente.
- Draft raportin e studimit shumë të rëndësishëm nga sekretariati i IOSCO-s për edukimin e investitorit. Investitorët duhet të njihen me parimet e edukimit të fushës, në mënyrë që të investojnë me mençuri e të mos bëhen viktima të mashtrimeve apo të mashtrojnë. Objektivat dhe Parimet e IOSCO-s i referohen tashmë rëndësisë së edukimit të investitorëve në çështjen 6 të Parimit 3: "Rregullatorët duhet të luajnë një rol aktiv në promovimin e edukimit të investitorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në treg." G20 gjithashtu ka deklaruar një interes në shqyrtimin e mundësive për të përparuar financimin e mbrojtjes së konsumatorit nëpërmjet mundësive të informimit që përfshijnë: transparencën dhe edukimin; mbrojtjen nga abuzimet, mashtrimin dhe gabimet, etj.

Në fund u prezantuan prioritetet e ERC për vitin e ardhshëm.

*Pjesëmarrja e AMF-së në këtë takim i shërbeu zhvillimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe pikëpamjeve për zhvillimet e reja të tregut financiar jo-bankar rajonal dhe forcimit të bashkëpunimit midis autoriteteve mbikëqyrëse në këtë sektor të rëndësishëm financiar.*

### ***Për këtë numër punuan:***

**E. Shehi, R. Guri, D. Kalaja, Dh. Hazbiu,  
R. Eltari, E. Kokona**

